

Dr. Ruzha  
Kom. L. Ruzha  
Kom. Ruzha  
27/07/2022



NR 1646 DATE 26.07.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHQIPËRISË

Nr. 1274/ Prot.

Tiranë, më 26.07.2022

**Lënda:** Informacion mbi disa çështje të cilat Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ndesh gjatë punës së tij të përditshme

**Znj. LINDITA NIKOLLA**

**KRYETARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

E nderuar znj. Nikolla,

Më lejoni që në emër të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) t'ju shpreh respektin, mirënjohjen për bashkëpunimin e ofruar për realizimin e misionit që ligji 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..." i ngarkon Autoritetit.

Në vijim të punës së përditshme, ndodhur në një situatë të pazakontë, por edhe të përsëritur, Autoriteti për Informim në mbledhjet e datës 25 Korrik dhe 26 Korrik 2022, doli me Vendimin nr. 324, datë 26.07.2022, i cili u mor në mënyrë unanime, për zgjidhjen e disa shqetësimeve të cilat na detyrojnë të rikërkojmë Institucionit që ju drejtoni kryerjen e disa ndryshimeve/rregullimeve ligjore të mundshme.

Siç jeni në dijeni në 27 korrik të vitit 2020, ligji ynë funksional me nr. 45/2015, ka pësuar disa ndryshime me ligjin nr. 114/2020, të cilat rregulluan disa çështje dhe shtuan disa kompetenca të Autoritetit.

Megjithatë në këto ndryshime nuk u përfshinë disa propozime që institucioni ynë kishte bërë nëpërmjet shkresave drejtuar Kuvendit dhe relacioneve të ndryshimeve ligjore.

Po të njëjtin shqetësim e kemi ngritur disa herë në raportet vjetore të Autoritetit, duke parashtruar shqetësimet tona si dhe rrugën si duhen zgjidhur këto problematika të hasura. Vlen të theksohet raportimi i fundit i Autoritetit, Raportin Vjetor 2021, në të cilën Anëtarja me detyrën e Kryetares i ka dhënë një vend të veçantë këtyre shqetësimeve.

Duke marrë shkas nga disa shqetësime të kohëve të fundit, përta i përket disa rasteve ku figura të verifikuara nga komisionet e mëparshme të pastërtisë së figurës si komisioni Mezini dhe Bezhani dhe të pajisur prej tyre me certifikata të pastërtisë së figurës të cilat nëse do të ishin lëshuar sot nga Autoriteti në kushtet e konsultimit të arkivës sonë dhe në zbatim të një metodologjie e standarti të qarta, këto certifikata të pastërtisë së figurës të këtyre subjekteve do të ishin të ndryshme.

Në vijim të kërkesave dhe propozimeve tona të mëparshme, por sidomos duke marrë nxitje nga denoncimi më i fundit i ardhur në institucion mbi pastërtinë e figurës së një prej personaliteteve më të larta të shtetit siç është, ish Presidenti i Republikës Z Ilir Metaj, i pajisur me certifikatë të pastërtisë së figurës nga Komisioni Mezini dhe Bezhani, e konfirmuar nga ana jonë me Vendimin e Autoritetit nr. 17, datë 28.04.2017, rezulton se në fakt figuron në dokumentet e krijuara nga strukturat e ish-Sigurimit të Shtetit. Nëse institucioni do të ishte në kushtet e riverifikimit të pastërtisë së figurës të shtetasit Ilir Metaj, gjë të cilën nuk na e lejon neni 29, pika 4, e ligjit funksional, rezultatet e kërkimit do të ndryshonin.

Me qëllim që situata të tilla të mos përsëriten më dhe në përndjekje të qëllimit për të mundësuar që personat që ushtrojnë detyra shtetërore aq më shumë ato subjekte që ushtrojnë detyra të larta shtetërore të mund të vlerësohen nga Autoriteti, Ju sjellim në vëmendje me qëllim miratimin nga na juaj të propozimit për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2015 të ndryshuar, si më poshtë vijojnë:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Nën nenin 63, pika 3, të ndryshohet si më poshtë:

“Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69

të Kushtetutës, për të cilin përfundon me sukses procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës, dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ”.

Pas nenit 63, shtohet neni 63/1 me këtë përmbajtje:

“Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës”

Subjekti zgjedhor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve, për listën e kandidatëve, për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës pastërtisë së figurës.

Kandidati i pavarur për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për të, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës pastërtisë së figurës.

Autoriteti kryen procesin e verifikimit dhe përgjigjet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 dhe 30, të ligjit nr. 44/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, duke informuar subjektin që ka bërë kërkesën dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Verifikimi i figurës së pastërtisë të kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie, ku vetë kandidati duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të vetë deklarojë, dhe nëse vet deklarimi është i rremë në raport me rezultatin e verifikimit sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit 45/2015, atëherë çështja dërgohet pranë KQZ-së, e cila e përcjell më tej në organet kompetente të hetimit dhe gjyqimit, veprime këto që sjellin penaltetet e duhura.

Në ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:



Zbatimi i nenit 29 pika 4, i ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar, në disa praktika të punës ka ngritur për diskutim dhe interpretim çështjen nëse në procesin e vendimarrjes, Autoriteti krahas respektimit të normës urdhëruese të parashikuar sa sipër, duhet të respektojë edhe detyrimin tjetër për të informuar institucionet kërkuese, udhëhequr nga parimi i transparencës sipas nenit 4 të ligjit 45 /2015 i ndryshuar, lidhur me rezultatin e verifikimit për të njëjtin shtetas dhe të pasqyrojë dokumentacion e identifikuar në një procedurë tjetër të mëparshme për të njëjtin shtetas.

Me anë të një norme me natyrë urdhëruese është shprehur qartazi se Autoriteti nuk mund të disponojë mbi kompetencën e dhënë nga ligjvënësi përndryshe tejkalon kompetencat e tij dhe një akt administrativ i nxjerrë në tejkalim të kompetencave në bazë të nenit 108 gërma a), pika 1) të Kodit të Procedurave Administrative përbën një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Sa më sipër, për subjektin përkatës, Autoriteti shprehet me dy vendimmarrje të ndryshme, njëri që subjekti zotëron certifikatën e pastërtisë së figurës së tij, dhe vendimi tjetër që po i njëjti subjekt rezulton psh. si bashkepunetor i ish sigurimit të shtetit.

Vlerësojmë se, çdo rrethanë apo informacion i njohur nga vetë kërkuesi dhe publiku dhe për të cilën Autoriteti është në dijeni apo disponon informacion se ekziston, duhet të pasqyrohet dhe të jetë pjesë përbërëse e vendimit në pjesën përshkruese dhe arsyetuese të secilit vendim.

E nderuar znj. Kryetare, në mënyrë që Autoriteti të jetë i pavarur, i besueshëm për shoqërinë shqiptare dhe faktorin ndërkombëtar, si dhe të kryejë punën e tij në mënyrën më transparente të mundshme dhe të jetë i lirë nga çdo insinuatë që kërkimi dhe rezultati arkivor nuk është bërë në mënyrën e duhur, Ju përcjellim informacionin e në lidhje me rastet më flagrante të konstatuara nga institucioni, ku disa figura të rëndësishme si: A. D., Th. S., S.H, Xh. Sh., D.Ç dhe I. M., të cilat kanë patur certifikatë të pastërtisë së figurës, figurojnë në dokumentet e krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, raste të cilat duhet të mbahen parasysh në vlerësimin tuaj në lidhje me miratimin nga ana e Kuvendit të propozimeve për ndryshime ligjore të cilat do t'i gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese.

Bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni:

- 2- Propozim për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë;
- 3- Propozim për disa ndryshime ligjore në ligjin 45/2015;
- 4- Vendimin e Autoritetit me nr. 34 datë 26.07.2022.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**ANËTAR NË DETYRËN KRYETARIT**

**Dr. Gentiana Sula**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Nr. 1278 Prot.

Tiranë, më 26.07.2022

V E N D I M  
Nr. 321 datë 26.07.2022

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë në mbledhjen e datës 26.07.2022, me pjesëmarrjen e anëtarëve:

Zj. Gentiana Sula	Kryetare
Z. Albert Nikolla	Anëtar
Z. Altin Hoxha	Anëtar
Z. Gjergj Marku	Anëtar
Z. Skënder Vrioni	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Shqyrtimi i propozimit për ndryshime ligjore dhe informim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit", e miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit, e ndryshuar.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pasi shqyrtoi propozimet për disa ndryshime ligjore për disa dispozita të ligjit 45.2015 si dhe Kodit zgjidhor të Republikës së Shqipërisë

V Ë R E N

Ligji nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" përcakton se, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si institucion i pavarur, është përgjegjës për zbatimin e ligjit, lidhur me mbledhjen, administrimin, përpunimin, përdorimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe informimin në lidhje me to të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj. Autoriteti në disa raste ka dalë me dy vendimmarrje të ndryshme, për të njëjtin subjekt ku në një procedurë Autoriteti është vënë në lëvizje me kërkesë të paraqitur nga institucione



kushtetuese apo autoritete publike dhe Vendimmarrja ka rezultuar që subjekti zotëron certifikatën e pastërtisë së figurës së tij dhe në procedurë tjetër ku Autoriteti është vënë në lëvizje me kërkesë të paraqitur nga persona të prekur nga aktiviteti i strukturave të ish-Sigurimit të Shtetit. dhe vendimi tjetër që po i njëjti subjekt rezulton p.sh. si bashkëpunëtor i ish sigurimit të shtetit, anëtar i ish Sigurimit, hetues apo gjyqtar. Kjo pasi dispozita urdhëruese e nenit 29 pika 4 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, zbatohet vetëm për kërkesat për informim të paraqitura nga institucionet kushtetuese dhe autoriteteve publike, dhe jo për kërkesat individuale për informim, ku Autoriteti nuk kushtëzohet nga normë urdhëruese dhe në këtë kontekst e jep dokumentacionin sic rezulton nga verifikimi.

Duke marrë shkas nga disa shqetësime të kohëve të fundit, përsa i përket disa rasteve ku figura të verifikuara nga komisionet e mëparshme të pastërtisë së figurës si komisioni Mezini dhe Bezhani dhe të pajisur prej tyre me certifikata të pastërtisë të figurës të cilat nëse do të ishin lëshuar sot nga Autoriteti në kushtet e konsultimit të arkivës sonë dhe në zbatim të një metodologjie e standarti të qarta, këto certifikata të pastërtisë së figurës të këtyre subjekteve do të ishin të ndryshme.

Me qëllim që situata të tilla të mos përsëriten më dhe në përndjekje të qëllimit për të mundësuar që personat që ushtrojnë detyra shtetërore aq më shumë ato subjekte që ushtrojnë detyra të larta shtetërore të mund të vlerësohen nga Autoriteti, nevojitet miratimi i propozimit për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ndryshime në ligjin nr. 45/2015 të ndryshuar, me formulimin si më poshtë:

1. Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

#### **Neni 1**

Nën nenin 63, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës, për të cilin përfundon me sukses procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës, dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ”.

#### **Neni 2**

Pas nenit 63, shtohet neni 63/1 me këtë përmbajtje:

#### **Neni 63/1**

#### **“Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës”**

1. Subjekti zgjedhor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve, për listën e kandidatëve, për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës pastërtisë së figurës.
2. Kandidati i pavarur për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me

ekzistencën për të, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës pastërtisë së figurës.

3. Autoriteti kryen procesin e verifikimit dhe përgjigjet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 dhe 30, të ligjit nr. 44/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, duke informuar subjektin që ka bërë kerkësën dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
4. Verifikimi i figurës së pastërtisë të kandidatëve për deputet apo kryetar bashkie, ku vetë kandidati duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të vetë deklarojë, dhe nëse vet deklarimi është i rrethë në raport me rezultatin e verifikimit sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit 45/2015, atëherë çështja dërgohet pranë KQZ-së, e cila e përcjell më tej në organet kompetente të hetimit dhe gjyqimit, veprime këto që sjellin penaltetet e duhura.

Në ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

Pika 4, e nenit 29, shfuqizohet.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe Rregulloren e Brendshme të Institucionit “Për Organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, të ndryshuar, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

### V E N D O S I

1. Përcjelljen Kuvendit të Shqipërisë të shkresës me nr. \_\_ datë 26.07.2022, “Informacion mbi disa çështje shqetësuese të cilat Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ndesh gjatë punës së tij të përditshme”
2. Miratimin e propozimeve për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin 45/2015;
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR NË DETYRËN KRYETARIT**

**Dr. Gentiana Sula**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**Dr. Albert Nikolla**

**Altin Hoxha**

**Gjergj Marku**

**Skënder Vrioni**



# PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_/2022

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008, “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

### KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

#### Neni 1

Nën nenin 63, pika 3, ndryshohet si më poshtë:

“Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës, për të cilin përfundon me sukses procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës, dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendorë në KZAZ”.

#### Neni 2

Pas nenit 63, shtohet neni 63/1 me këtë përmbajtje:

#### Neni 63/1

#### “Procesi i verifikimit të pastërtisë së figurës”

1. Subjekti zgjedhor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve, për listën e kandidatëve, për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, potencialisht e mundshem paraqet kërkesë dhe formualin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në

lidhje me ekzistencën për ta të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës pastërtisë së figurës.

2. Kandidati i pavarur për deputet, për kryetar bashkie dhe për këshillat vendor, 70 ditë para datës së zgjedhjeve paraqet kërkesë dhe formularin e plotësuar të aplikimit pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me ekzistencën për të, të informacioneve në dokumente të ish-sigurimit të shtetit, për qëllime të transparencës së pastërtisë së figurës.
3. Në çdo rast Autoriteti me marrjen njoftim nga KQZ-ja, lidhur me regjistrimin e listës së kandidatëve 50 ditë përpara ditës së zgjedhjeve që konkurojnë për zgjedhjet e radhës, kryen procesin e verifikimit dhe përgjigjet në përputhje me përcaktimet e nenit 26 dhe 30, të ligjit nr. 44/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", të ndryshuar, duke informuar subjektin që ka bërë kërkesën dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
4. Verifikimi i figurës së pastërtisë të kandidateve për deputet apo kryetar bashkie, ku vetë kandidati duhet të plotësojë formularin e aplikimit dhe të vetë deklarojë, dhe nëse vet deklarimi është i rremë në raport me rezultatin e verifikimit sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit 45/2015, atëherë çështja dërgohet pranë KQZ-së, e cila e përcjell më tej në organet kompetente të hetimit dhe gjykimit, veprime këto që sjellin penalitetet e duhura.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**LINDITA NIKOLLA**



**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 45/2015 “PËR TË DREJTËN E  
INFORMIMIT PËR DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT TË  
REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

**Neni 1**

Pika 4, e nenit 29, shfuqizohet.

**Neni 2  
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
LINDITA NIKOLLA**